



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 14.02.2025

Nr: 99

Ora: 12:00

VENDIM

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE BAZUAR NË  
DENONCIMIN NR. 8, DATË 10.02.2025, TË REGJISTRIT TË DENONCIMEVE,  
TË PARTISË DEMOKRATIKE**

Sot më datë 14.02.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi mori në shqyrtim paraprak denoncimin me:

**KËRKUES:** Partia Demokratike

**SUBJEKT:** Z. Erion Isai  
Kryetar i Bashkisë Kolonjë

**OBJEKT:** Përdorimi i burimeve publike dhe funksionit publik në mbështetje të subjekteve zgjedhore

**BAZA LIGJORE:** Neni 91, pikat 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullaror

**KONSTATOJ:**

Partia Demokratike, më datë 10.02.2025, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, denoncimin e administruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 8 ID.

Në këtë denoncim Partia Demokratike parashton sa vijon:

1. “Kryetari i bashkisë Kolonjë ka nisur të shpërdorojë fondet publike për të udhëtuar drejt Greqisë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, me qëllimin e vetëm për të bërë fushatë politike dhe për të ndikuar te emigrantët për zgjedhjet e datës 11 Maj 2025”.

Data: 14.02.2025

Nr: 99  
Ora: 12:00



“Për fillimin e procedurës administrative bazuar në denoncimin nr. 8, datë 10.02.2025 të regjistrin të denoncimeve, të Partisë Demokratike”

2. *“Z. Isai në kundërshtim të hapur me ligjin regjistron emigrantët në PER në favor të Partisë Socialiste, duke përdorur funksionin e tij publik për të favorizuar një parti politike”.*

Nga sa më sipër çmoj se, ekzistojnë kushtet për t’u nisur hetimi administrativ.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

### **V E N D O S:**

1. Fillimin e procedurës administrative ndaj z. Erion Isai Kryetar i Bashkisë Kolonjë.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**